



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
Këshilli Drejtues

**V E N D I M**

**Nr.22, datë 01.12.2017**

**Mbi**

**“Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a tek Sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a.”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 01.12.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimi i aktit administrativ “Mbi dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sha.a tek Sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a.”

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 74 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr. 30**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2395, datë 05.12.2013.

3. Rregullore 31, datë 26.12.2013 “Mbi termat e përgjithshëm të Kontratës së Pajtitimit”
4. Rregullore nr. 10, datë 11.8.2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

1. Kërkesë e Plus Communication Sh.a. drejtuar AKEP me shkresën nr. 744, datë 18.07.2017 (prot. i AKEP nr.1620 datë 18.07.2017) ku ka kërkuar miratimin paraprak nga AKEP për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Plus Communication sh.a. tek operatorët e tjerë celularë. (***Kërkesa e Plus Communication***);
2. Shkresë nr. 1034 Prot., datë 23.10.2017, e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a. me anë të së cilës ka depozituar në AKEP kopje të marrëveshjeve për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Plus Communication sh.a. tek operatorët e tjerë celularë (***Shkresa nr. 1034 Prot***);
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.20, datë 13.11.2017 për “*Dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communications Sh.a., tek sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., dhe Vodafone Albania Sh.a*” njoftuar sipërmarrësve dhe Autoritetit të Konkurrencës respektivisht me shkresat Nr.1620/11 Prot.AKEP, datë 13.11.2017 dhe Nr. 1620/10 Prot.AKEP, datë 13.11.2017;
4. Vendim Nr. 485, datë 23.11.2017 i Autoritetit të Konkurrencës për “*Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA*” përcjellë me shkresën Nr.1620/12 Prot.AKEP, datë 30.11.2017.
5. Shkresat nr.1490 Prot., datë 01.12.2017 e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., Ref.LEA/101/IL e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. dhe Albtelcom Sh.a. me nr. 8812 Prot., datë 01.12.2017.
6. Dokumentacioni shoqërues :
  - a) Shkresë nr. 1061 Prot., datë 26.10.2017 (Nr. 1420/1Prot. i AKEP datë 27.10.2017) “Dërgohet mandat pagesa e faturave të datës 01.02. 2017 me nr. 470 Prot., nr. 471 Prot., nr. 473 Prot, si dhe fatura e datës 06.06 2017, me nr. 1420 Prot.”
  - b) Shkresë nr. 6904/1Prot., datë 27.10.2017 (nr. 1620/8Prot. i AKEP, datë 31.10.2017) “Mbi marrëveshjen paraprake mes palëve për transferimin e të drejtës për përdorimin e frekuencës”;
  - c) Autorizimet Individuale të sipërmarrësit Plus Communication sh.a. miratuar me VKD Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar me VKD Nr. 2567, datë 11.05.2015 dhe VKD Nr. Nr. 2677, datë 21.04.2016.

Si dhe:

- Interpretimit të bazës ligjore referuese;
- Analizës së fakteve dhe provave shkresore të paraqitura;
- Diskutimeve në mbledhjen e KD datë 01.12.2017;

## V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi Plus Communication sh.a. ushtron veprimtarinë e vet në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar me VKD Nr. 2567, datë 11.05.2015 dhe është pajisur nga AKEP me Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave GSM 900 dhe GSM 1800 me qëllim ndërtimin e rrjetit të lëvizshëm të komunikimeve publike GSM, për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm tokësor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. AKEP, me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2677, datë 21.04.2016 ka pajisur me Autorizim Individual sipërmarrësin “Plus Communication” sh.a., për përdorimin e frekuencave në brezin 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160 - 2170 MHz.
3. Sipërmarrësi Plus Communication Sh.a., i është drejtuar AKEP me shkresën nr. 744 datë 18.07.2017 (prot. i AKEP nr.1620 datë 18.07.2017), “*Kërkesë për miratimin paraprak për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Shoqërisë Plus Communication sh.a., tek operatorët e tjerë celularë*”.
4. Sipas informacionit të pasqyruar në shkresë, sipërmarrësi Plus Communication Sh.a., bën me dije se në mbështetje të përcaktimeve të parashikuara në nenin 74 të ligjit nr. 9918/2008 ka filluar procesin e bisedimeve me sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., dhe Vodafone Albania Sh.a., për transferimi e të drejtave të përdorimit të frekuencave që disponon sipas autorizimeve individuale përkatëse tek këta operatorë që gjithashtu ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Në procesin e bisedimeve, pavarësisht faktit që nuk do të jetë pjesë e procedurës për transferimin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave, është përfshirë edhe sipërmarrësi Altelecom Sh.a., duke u bërë në këtë mënyrë pjesë e procesit, dakortësisë për transferimin e të drejtës së përdorimit sipas autorizimeve individuale nga sipërmarrësi Plus Communication Sh.a., tek dy sipërmarrësit e tjerë, si dhe negocimit të një marrëveshje të mundshme në këtë kuadër me sipërmarrësin Plus Communication Sh.a.
6. Në vijim Plus Communication Sh.a., me shkresë nr. 1034 Prot., datë 23.10.2017, ka depozituar në AKEP kopje të marrëveshjeve për transferimin e frekuencave dhënë në përdorim sipërmarrësit Plus Communication sh.a. tek operatorët e tjerë celularë, si dhe ka njoftuar AKEP për kryerjen e plotë të pagesës për tarifën e radiokomunikimit dhe pagesave që kryhen në AKEP sipas ligjit nr. 9918/2008, për vitin 2017.
7. Transferimi i autorizimit individual të dhënë nga AKEP për përdorimin e frekuencave, tek një sipërmarrës tjetër, parashikohet ligjërisht sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit nr. 9918, datë 9.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar (**Ligji nr. 9918/2008**).
8. AKEP me Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.20, datë 13.11.2017 për “*Dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., tek sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., dhe Vodafone Albania Sh.a*” ka vendosur dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e kërkuar, dhe me disponimin e

vendimit të Autoritetit të Konkurrencës, AKEP do të pasqyrojë ndryshimet e ndodhura me të drejtat e përdorimit të frekuencave në Autorizimet Individuale përkatëse duke garantuar maksimizimin e shfrytëzimit efektiv të spektrit.

9. Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr.485, datë 23.11.2017 për “*Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA*” ka autorizuar përqëndrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes PLUS COMMUNICATION SHA tek TELEKOM ALBANIA SHA.
10. Relacioni i paraqitur nga struktura përgjegjëse përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 74 dhe jep përgjigje për sa përcaktohet në këtë dispozitë.

### **ARSYETON:**

1. Referuar përcaktimeve të nenit 74 të ligjit nr. 9918/2008, Plus Communication sh.a. ka të drejtë të kërkojë transferim e të drejtës për përdorim të frekuencave të brezave 900/1800/2100 MHz si një sipërmarrës i pajisur nga AKEP me autorizim individual për përdorimin e tyre.
2. Në zbatim të procedurës për transferimin e të drejtës për përdorim të frekuencave, në interpretim të nenit 74 të ligjit nr. 9918/2008, Plus Communication sh.a. ka paraqitur tek AKEP kërkesën me shkrim për miratimin paraprakisht të këtij transferimi tek sipërmarrësi Telekom Albania sh.a., të cilit do t’i kalojë e drejta e përdorimit të ½ së spektrit të frekuencave 900/1800/2100 MHz.
3. AKEP, si organi kompetent sipas ligjit nr. 9918/2008 për administrimin e spektrit të frekuencave, në përfundim të procedurës për realizimin e transferimit, pasi janë përmbushur kushtet ligjore sipas legjislacionit, pajis sipërmarrësin Telekom Albania sh.a. të cilit do t’i kalojë e drejta e përdorimit të frekuencave për ½ e sasisë së spektrit në përdorim nga Plus, me autorizimin individual për përdorimin e tyre.
4. Në përfundim, të procesit të verifikimit, vlerësimit, dhënies paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a. dhe me disponimin e vendimit të Autoritetit të Konkurrencës, AKEP pasqyron ndryshimet e ndodhura me të drejtat e përdorimit të frekuencave në Autorizimet Individuale përkatëse duke garantuar maksimizimin e shfrytëzimit efektiv të spektrit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74, neni 114 dhe nenin 115;
2. VKM Nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,

3. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave” (**Rregullore nr. 30**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2395, datë 05.12.2013.

### V E N D O S:

1. Transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a. tek sipërmarrësi Telekom Albania sh.a.
2. Të pajisë me Autorizim Individual sipërmarrësin “Telekom Albania” sh.a. sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Autorizimi Individual i sipërmarrësit Telekom Albania sh.a. dhënë me këtë vendim hyn në fuqi më 01.01.2018.
4. Sipërmarrësi Telekom Albania sh.a. duhet të fillojë shfrytëzimin e frekuencave brenda 2 (dy) muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Autorizimi Individual.
5. Sipërmarrësi Plus Communication sh.a. do të përdorë spektrin e frekuencave te brezave 900/1800/2100 MHz deri në datën 31.12.2017. Pas këtij afati përfundon vlefshmëria e autorizimeve individuale të frekuencave dhënë sipërmarrësit Plus Communication Sh.a. me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 745, datë 26.06.2009, i ndryshuar, dhe Nr. 2677, datë 21.04.2016.
6. Plus Communication deri më datë 31.12.2017 duhet të njoftojë në AKEP, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi ndryshimet në njoftimin e regjistrimit të Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike që lidhen me përcaktimet në këtë vendim.
7. Numrat e alokuar sipërmarrësit Plus Communication Sh.a. sipas aneksit 3 të VKD Nr. 745, datë 26.06.2009 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit për ofrimin e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike (telefoni e lëvizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë – “Mobile 4 Al” sh.a”, i ndryshuar, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, kalojnë në administrimin e AKEP, si burime të fundme natyrore, duke filluar nga data 1 Janar 2018.
8. Plus Communication Sh.a., detyrohet që në përputhje me ligjin nr. 9918/2008, aktet rregullatore në fuqi dhe kontratave të lidhura me pajtimtarët dhe përdoruesit e tij të njoftojë pajtimtarët për datën e përfundimit të ofrimit të shërbimeve (por jo më vonë se 30 ditë para kësaj date) dhe mundësitë alternative që kanë për të realizuar përzgjedhjen e operatorit të ri, Telekom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a. ose Albtelecom sh.a., për vijimin e marrjes së këtyre shërbimeve.
9. Sipërmarrësit Telekom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a. dhe Albtelecom sh.a. duhet të njoftojnë pajtimtarët e rrjeteve të tyre përdorues të numrave me prefiks të lëvizshëm “66” që afati i përdorimit të këtij prefiksi është deri me 31 Dhjetor 2017.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, AKEP fillon zbatimin e masave teknike dhe administrative të nevojshme për maksimizimin e kapaciteteve të pranimit

dhe ekzekutimit të kërkesave për bartje/në ditë të sistemit të CRDB, në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë vendim.

11. Mospbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim për të gjithë sipërmarrësit pjesëmarrës në këtë proces që përbëjnë kundërvajtje administrative do të trajtohen në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2008, i ndryshuar, dhe kuadrin rregullator në fuqi.
12. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_